



FORUMI I KËSHILLIT PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

19.01	2	
SKOMSTR	174/2022	1/7



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1188/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arditë Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Malësore Gashi-Bajraktari, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.2605/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën A.nr.540/2019 të datës 13.09.2019, të parashtruar nga ankuesi

me
Prishtinë, kundër organit të punësimit Këshilli Prokurorial i Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datë 14.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.540/2019 e datës 13.09.2019, e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimi KA.Nr.25/2019 i datës 15.08.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës si dhe Vendimi me numër protokoll DPSKPK/34/2019 i datës 16.08.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
- III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokuroria të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimit, të ndërmer veprimet e nevojshme ligjore për sistemimin e ankuesit në një pozitë të punës e cila i përgjigjet kualifikimit dhe përvojës së tij, ekuivalente me pozitën të cilën ankuesi e ka ushtruar sipas Akt Emërimit DS-035-2018 të datës 14.02.2018.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve siç përcaktohet në pikën tre (3) të dispozitivit.

Arsyetim

Ankuesi me datë 13.09.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 4489/2019, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.nr.25/2019 të datës 15.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, me datë 17.09.2019, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës. Këshilli, me datë 23.09.2019 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli, me datë 04.10.2019 përmes shkresës me numër protokoli 4666/2019, ka njoftuar ankuesin se nuk mund të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesën e tij të datës 13.09.2019, në mungesë të kuorumit, dhe ka udhëzuar të njëjtin që të ushtroje mjetet tjera juridike në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, përmes Aktgjykimit A.nr.2605/2019, ka aprovuar kërkesë padinë e ankuesit të datës 04.01.2020, ka anuluar njoftimin e datës 04.10.2019 dhe ka obliguar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesën A.nr.540/2019 të datës 13.09.2019 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër A.nr.540/2019 të datës 13.09.2019; Aktgjykimin A.nr.2605/2019 të datës 13.12.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Administrative; Mendimin Juridik të Avokatit të Popullit; Ankesën e datës 24.07.2019 drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Vendimin KA.Nr.25/2019 të datës 15.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Vendimin me numër protokoli DSKPK/219/2019 të datës 19.06.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK-së; Akt Emërimit me reference DBNJ/DSKPK-674/2019 të datës 01.07.2019; Kërkesën për transferimin e ankuesit të datës 25.06.2019; Opinionin nga MAP përmes e-mailit; Titujt e Vendeve të Punës të plotësuar dhe ndryshuar në Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në kërkesë me numër protokoli 1074 të datës 08.07.2019; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i Zyrës për Shërbime të Përgjithshme në Zyrën e Prokurorit Disiplinor; Procesverbalin e datës 01.08.2019; Vendimin me numër KPK/NR350/2019 të datës 07.06.2019, të Kryesuesit të KPK-së; Vendimin me numër protokoli DSKPK/219/2019 të datës 19.06.2019; i Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK-së; Organogramin e Zyrës së Prokurorit Disiplinor; Shpalljen e Konkursit të datës 18.07.2019 për pozitën e Drejtorit të Departamentit për Burime Njerëzore, Prokurim dhe Administratë; Vendimin me numër protokoli DSKPK/314/2019 të datës 16.08.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK-së; Akt Emërimit me referencë DS-035-2018 të datës 14.02.2018; Kërkesën për harmonizimin e pagës për pozitën e punës Drejtor i Zyrës për Shërbime të Përgjithshme të datës 02.05.2018; Vendimin me numër protokoli KGJK nr.14/2018

të datës 30.05.2018; Vendimin me numër protokoll 03/2938 të datës 03.11.2014 për transferimin e përhershëm; Akt Emërimin me numër reference 03/303 të datës 03.11.2014; Shkresën për transferim të ankuesit me numër protokoll 01/2720 të datës 15.10.2014; Shkresën/kërkesë për transferim me numër prot:01/2593 të datës 30.09.2014; Akt Emërimin me numër protokoll 03/296 të datës 22.09.2014; e-mailin e datës 18.08.2014 nga B.G fq.1/2; Vendimin me numër protokoll 03/112-1814 të datës 06.12.2012; Akt Emërimin me numër protokoll 03-112-1423 të datës 31.12.2012; Akt Emërimin me numër reference 03-112-1667 të datës 04.06.2012; Akt Emërimin me numër protokoll 03-112-365 të datës 27.12.2011; Përgjigjen në ankesë me numër protokoll 4454/2019 të datës 23.09.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në Aktgjykimin me numër A.nr.2065/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Administrative dhe pas analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e bazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës rezulton se ankuesi që nga dhjetori i vitit 2011 ka qenë i punësuar në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, kurse sipas Akt Emërimin me referencë DS-035-2018 të datës 14.02.2018, i njëjti është emëruar Drejtor i Zyrës për Shërbime të Përgjithshme në Zyrën e Prokurorit Disiplinor në kuadër të Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Siç përcaktohej me nenin 16 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokurorëve, Këshilli Prokurorial i Kosovës (tutje KPK) ka nxjerrë Vendimin KPK/Nr.350/2019 të datës 07.06.2019 për transferimin e stafit të ish Zyrës së Prokurorit Disiplinor në njësitë organizative të Administratës së Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Prokurorit të Shtetit. Në zbatim të këtij vendimi, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së, përmes Vendimit me numër protokoll DSKPK/219/2019 të datës 19.06.2019, kishte bërë caktimin e tetë zyrtarëve të ish Zyrës së Prokurorit Disiplinor në kuadër të njërive të Sekretariatit të KPK-së, ashtu që ankuesi Fehmi Zena, ishte caktuar në pozitën e punës Drejtor i Zyrës për Shërbime të Përgjithshme në Divizionin për Administratë dhe njëkohësisht me këtë vendim përcaktohej se akt emërimet e zyrtarëve sipas këtij vendimi do të vlejnjë deri në rishikim të Strukturës së Administratës në Sistemin Prokurorial të Republikës së Kosovës.

Ankuesi i pakënaqur me caktimin e tij në pozitën Drejtor i Zyrës për Shërbime të Përgjithshme në Divizionin për Administratë në Sekretariatit e KPK-së, fillimisht me datë 25.06.2019 ka parashtruar kërkesë me shkrim të Kryesuesi i KPK-së dhe Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së, për transferim në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Burime Njerëzore, Prokurim dhe Administratë në kuadër të SKPK-së, pasi që e njëjta pozitë ishte e lirë dhe ekuivalente me pozitën e tij si Drejtor i Shërbimeve të Përgjithshme. Ndërsa, në përgjigje të kërkesës së ankuesit, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së, përmes shkresës me numër protokoll 1074/2019 të datës 08.07.2019, informon ankuesin se: *"kërkesa juaj për transferim në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Burime Njerëzore, Prokurim dhe Administratë nuk mund të realizohet sepse transferimi juaj është bërë konform nenit 16 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokurorëve andaj këtë transferim nuk e lejon struktura aktuale e SKPK-së".*

Me datë 01.07.2019 ankuesit i është ofruar Akt Emërimi DBNJ/DSKPK-674/2019, pa afat, për pozitën e punës Drejtor i Zyrës së Shërbimeve të Përgjithshme në Divizionin për Administratë, me koeficient 17.2 të pagës, e të cilin Akt Emërim ankuesi refuzon ta nënshkruaj, me pretendimin

se kjo pozitë nuk është e së njëjtës kategori funksionale dhe gradë të punës me pozitën të cilën e ka ushtruar ankuesi në ish Zyrën e Prokurorit Disiplinor.

Ankuesi me datë 24.07.2019, parashtroi ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të KPK-së, kundër Vendimit me numër protokoll DSKPK/219/2019 të datës 19.06.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK-së, Akt Emërimit DBNJ/DSKPK-674/2019 të datë 01.07.2019, Përgjigjes së Drejtorit të Përgjithshëm numër protokoll 1074/2019 të datës 08.07.2019 Z-010 si dhe Konkursit të shpallur me datë 18.07.2019 për pozitën e punës Drejtor i Departamentit për Burime Njerëzore, Prokurim dhe Administratë.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKPK-së, me Vendimin KA.Nr.25/2019 të datës 15.08.2019, ka refuzuar ankesën e ankuesit të datës 24.07.2019 dhe ka lenë në fuqi Vendimin me numër protokoll DSKPK/219/2019 të datës 19.06.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK-së.

Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së, përmes Vendimit me numër protokoll DSKPK/314/2019 të datës 16.08.2019, ka revokuar Akt Emërimit DBNJ/DSKPK-674/2019 të datës 01.07.2019 dhe ankuesit i ka ndërprerë marrëdhënien e punës nga data 01.08.2019, me arsyetimin e vetëm se ankuesi ka refuzuar ta nënshkruaj Akt Emërimit DBNJ/DSKPK-674/2019 të datës 01.07.2019.

Ankuesi kundër Vendimit KA.Nr.25/2019 të datës 15.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, brenda afatit ligjor parashtroi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Me tej, ankuesi thekson se pozita në të cilën është caktuar sipas Vendimit me numër protokoll DPSKPK/34/2019 të datës 16.08.2019 nuk është e së njëjtës kategori funksionale dhe gradë të punës me pozitën të cilën e ka ushtruar në Zyrën e Prokurorit Disiplinor, pasi që kjo pozitë sipas katalogut të vendeve të punës së Shërbimit Civil është pozitë e nivelit të lartë drejtues, ndërsa sipas Akt Emërimit DBNJ/DSKPK-674/2019 të datës 01.07.2019, mbikëqyrësi im është caktuar nëpunësi me pozitë me të ulët se pozita ime.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës përkatësisht nenin 32 paragrafi 1 dhe 2 ku është përcaktuar se "Nëpunësit civilë, të cilët janë tepricë pas riorganizimit, suprimimit ose bashkimit të organizatës së tyre me një organizatë tjetër në kuadër të institucionit të cilit i takojnë, do të ricaktohen në administratën qendrore ose komunale, po që se ekzistojnë pozita ekuivalente. 2. Në rast të mungesës së pozitive ekuivalente, nëpunësit civilë tepricë janë në përkujdesje të Qeverisë, gjegjësisht të ministrisë përgjegjëse për administratë publike, e cila përkujdeset për ricaktimin dhe trajnimin e këtyre nëpunësve civilë" si dhe dispozitat e Rregullores Nr.08/2012 për Nëpunësit Civilë Tepricë përkatësisht nenin 4 ku parashihet se: "Në rastin e riorganizimit të një institucioni, njësia e personelit ka këto përgjegjësi: 1.1. të identifikojë nëpunësit civilë, pozitat e të cilëve janë suprimuar dhe t'i regjistrojë ata në regjistrin e nëpunësve civilë tepricë; 1.2. të njoftojë nëpunësit civilë tepricë për të drejtat dhe detyrimet e tyre, që dalin nga statusi i nëpunësit civil tepricë që përcaktohet me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (me tej: Ligji) dhe me këtë Rregullore; 1.3. të përpiqet të gjejë një pozitë ekuivalente të lirë për nëpunësin civil tepricë brenda institucionit. 2.Nëse institucioni nuk mund të ricaktojë nëpunësin civil tepricë në një pozitë ekuivalente brenda një muaji, nga data në të cilin nëpunësi civil është shpallur tepricë, përgjegjësia për menaxhimin e këtyre nëpunësve civilë i kalon ministrisë përgjegjëse për

administratë publike” dhe rrjedhimisht Kolegji në kuptim të këtyre dispozitave ligjore vlerëson se në rastin e shuarjes së Zyrës së Prokurorit Disiplinor, njësia përgjegjëse fillimisht është dashur të identifikoj stafin shtesë, të përgatis listën rezerve dhe të bëjë përpjekje që stafin tepriçë ta ri caktoj në pozita ekuivalente të lira brenda institucionit, e nëse sistemimi në pozita ekuivalente nuk ka qenë i mundur, atëherë, përgjegjësia e menaxhimit të stafit tepriçë duhej t’i bartej ministrisë gjegjëse respektivisht Ministrisë për Administratë Publike.

Përkritazi me pretendimin ankimor të ankuesit se pozita në të cilin është caktuar ankuesi sipas Vendimit me numër protokolli DSKPK/219/2019 të datës 19.06.2019, nuk ka qenë pozitë ekuivalente me pozitën të cilën ankuesi e ka ushtruar në Zyrën e Prokurorit Disiplinor si Drejtor i Zyrës për Shërbime të Përgjithshme, Kolegji ka analizuar Akt Emërimin DS-035-2018 të datës 14.02.2018 dhe përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i Zyrës për Shërbime të Përgjithshme në Zyrën e Prokurorit Disiplinor, dhe si rrjedhojë është konstatuar se kjo pozitë e punës është kategorizuar si pozitë e nivelit drejtues 4, me Kod të punës DR/1110, koeficient 10 të pagës, dhe raportim të drejtpërdrejtë të Drejtori i Zyrës së Prokurorit Disiplinor. Ndërlidhur me këtë konstatim dhe duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1 të Rregullores Nr.05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, Kolegji konstatoi se pozita drejtuese e nivelit 4, është pozitë drejtuese që menaxhon një departament në kuadër të institucionit, e po ashtu bazuar në Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr.09 të datës 11.02.2018 të Ministrit të Ministrisë së Administratës Publike, titulli i punës *Drejtor i Zyrës për Shërbime të Përgjithshme* kategorizohet me kodin e punës AD/1110 me gradë 4.

Ndërsa përkritazi me analizimin e Akt Emërimin DBNJ/DSKPK-674/2019 të datës 01.07.2019, për pozitën e punës Drejtor i Zyrës për Shërbime të Përgjithshme në Divizionin e Administratës në Sekretariatit e KPK-së, Kolegji konstatoi se i njëjti nuk përmban sqarime lidhur me kategorinë funksionale, gradën e pozitës, kodin e punës, si dhe nuk përfshinë përshkrimin e detyrave të punës për këtë pozitë ashtu siç kërkohet me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 dhe 1.7 dhe nenin 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Rregullores Nr.07/2010 për Emërimin e Nëpunësve Civil.

Me tej, Kolegji ka analizuar edhe Rregulloren Nr.09/2016 për Veprimtarinë, Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, dhe rrjedhimisht me këtë Rregullore nuk parashihej konkretisht pozita e punës *“Drejtor i Zyrës së Shërbimeve të Përgjithshme”*, kurse Divizioni për Administratë përcaktohet si njësi me veprim nën Departamentin për Burime Njerëzore, Prokurim dhe Administratë. Gjegjësisht, nisur nga ky konstatim, Kolegji vlerëson se pozita Drejtor i Zyrës së Shërbimeve të Përgjithshme në kuadër të Divizionit për Administratë edhe pse me koeficient të njëjtë të pagës, nuk konsiderohet pozitë ekuivalente me pozitën e punës Drejtor i Zyrës së Shërbimeve të Përgjithshme sipas Akt Emërimin DS-035-2018 të datës 14.02.2018, sepse Divizioni në kuptim të nenin 13 paragrafi 1 të Rregullores Nr.05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil është njësi me ulët se Departamenti, respektivisht nivel drejtues 2, kështu që mi këtë bazë ashtu siç pretendohet edhe nga ankuesi, i njëjti duhej ti raportonte udhëheqësit të Divizionit si pozitë me ulët se pozita e drejtorit të departamentit, andaj si rrjedhojë është i bazuar pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim.

Lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së Vendimit me numër DSKPK/314/2019 të datës 16.08.2019, me të cilin ankuesit i është revokuar Akt Emërimi DBNJ/DSKPK-674/2019 i datës

01.07.2019 dhe i është ndërprerë marrëdhënia e punës nga data 01.08.2019, për faktin se ankuesi ka refuzuar nënshkrimin e tij, Kolegji duke u bazuar në shqyrtimin e shkresave të lëndës ka konstatuar se Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së me nxjerrjen e Vendimit DSKPK/314/2019 të datës 16.08.2019, ka vepruar në kundërshtim me nenin 85 paragrafi 2 lidhur me nenin 87 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil ku përcaktohet se: *"Marrëdhënia e punës në shërbimin civil ndërpritet me vendim të njëanshëm në rast të: 2.1. dorëheqjes dhe shkarkimit nga shërbimi civil për arsyet e parapara me këtë ligj... Nëpunësi civil shkarkohet nga shërbimi civil për shkak të performancës dhe rezultateve të dobëta, shkeljes së kodit të mirësjelljes dhe shkeljes së ligjit, i cili ka rezultuar me veprë penale, siç është përcaktuar me këtë ligj"* si dhe në kundërshtim me Rregulloren Nr.01/2011 për Ndërprerjen, Pezullimin dhe Përfundimin e Marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil, konkretisht nenin 7 ku është përcaktuar se: *"1.Nëpunësi civil shkarkohet nga shërbimi civil për shkak të: 1.1 performancës dhe rezultateve të dobëta në punë dy vjet radhë, të vlerësuar nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë 1.2 shkeljes së kodit të mirësjelljes për shërbyesit civilë dhe 1.3. Në rast të kryerjes së veprës penale, siç parashihet me Ligjin për Shërbimin Civil. 2. Në bazë të nënparagrafit 1.1 të paragrafi 1 të këtij neni, njësi përgjegjëse e personelit i propozon Udhëheqësit me të Lartë Administrativ të institucionit përkatës të marrë vendim për shkarkimin e nëpunësit civil. 3.Në bazë të nënparagrafit 1.2 dhe 1.3 të paragrafi 1 të këtij neni, vendimin për shkarkimin e nëpunësit civil e merr komisioni disiplinor, Respektivisht duke ju referuar këtyre dispozitave ligjore Kolegji vlerëson se në rastin konkret, nuk ka ekzistuar asnjëra nga rrethanat ligjore për ndërprerje të njëanshme të marrëdhënies së punës se ankuesit sipas Vendimit DSKPK/314/2019 të datës 16.08.2019.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës po ashtu vëren se Vendimi me numër DSKPK/314/2019 i datës 16.08.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së, është në kundërshtim edhe me dispozitat e Rregullores Nr.07/2010 për Emërimin në Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 13 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 me të cilin parashihet se: *1. Emërimet, pavarësisht nëse janë me afat të caktuar apo të pacaktuar, mund të revokohen gjatë kohëzgjatjes së tyre në rastet në vijim: ...1.3 nëse nëpunësi civil njofton institucionin punëdhënës për mospranimin e emërimit në shërbimin civil, përkatësisht Kolegji vlerëson se dispozitat në fjalë i referohen emërimit për herë të parë në shërbim civil dhe mospranimin të emërimit në shërbimin civil, e jo rrethanave si në çështjen në ankesë, rrjedhimisht ankuesi kishte refuzuar nënshkrimin e Akt Emërimit DBNJ/DSKPK-674/2019 të datës 01.07.2019, vetëm mbi bazën se pozita e punës e ofruar nuk ishte ekuivalente më pozitën e tij të punës në ish Zyrën e Prokurorit Disiplinor, e në këtë kuptim Kolegji konstaton se një refuzim i tillë i ankuesit nuk paraqet bazë ligjore për ndërprerje të marrëdhënies së punës, dhe se organi i punësimit në rastin në fjalë duhej të mundësonte ankuesit ushtrimin e detyrës së punës sipas Akt emërimit DBNJ/DSKPK-674/2019 të datës 01.07.2019, ndërsa ankuesi mund të vazhdonte me tej procedurat ligjore në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të tij të pretenduara.*

Kolegji me rastin e trajtimit të pretendimeve ankimore mori parasysh edhe konstatimet sipas Mendimit Juridik të Avokatit të Popullit në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae), në lidhje me ankesën e ankuesit Nr.640/2019, përmes të cilit Institucioni i Avokatit të Popullit ka aprovuar ankesën e ankuesit si të arsyeshme, duke konstatuar se procedura e transferimit të ankuesit nga Zyra e Prokurorit Disiplinor në Sekretariatit të KPK-së, nuk ishte realizuar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, se ka pasur shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të ankuesi dhe së ndërprerja e marrëdhënies së punës se ankuesit është realizuar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.01/2011 për Ndërprerjen, Pezullimin dhe Përfundimin e Marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil.

Bazuar në të gjeturat si me lartë, Kolegji konstaton se një akt administrativ i nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e ligjit material është akt administrativ i paligjshëm ashtu siç përcaktohet me nenin 52 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e në këtë kuptim rrjedh se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës si dhe Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës me nxjerrjen e vendimeve të kontestuar, nuk kanë vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe nuk kanë zbatuar drejt dispozitat materiale ligjore, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave dhe Rregulloren Nr.01/2011 për Ndërprerjen, Pezullimin dhe Përfundimin e Marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil.

Andaj, organi i punësimit, gjegjësisht Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokuroria të Kosovës, obligohet të ndërmer veprimet e nevojshme ligjore për sistemimin e ankuesit në një pozitë të punës e cila i përgjigjet kualifikimit dhe përvojës së tij, ekuivalente me pozitën të cilën ankuesi e ka ushtruar sipas Akt Emërimit DS-035-2018 të datës 14.02.2018. Vetëm nëse nuk ka pozitë ekuivalente të lirë, ankuesi mund të sistemohet në pozitë me të ulët drejtuese.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur MbiKëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1188/2021

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Arkivit të KPMShCK-së

Ardita HAXHNIKAJ - DEMI

Kryetare e Kolegjit

